# KRIJIMI I PROFILIT TË MATURANTIT NË PORTALIN E-ALBANIA DHE APLIKIMI ME FORMULARIN A1 / A1Z

1. Hapim një prej browser-ave Internet Explorer/Firefox/Chrome/etj. Tek fusha e adresës web plotësojmë www.e-albania.al dhe shtypim ENTER. Hapet faqja kryesore e Portalit e-albania siç tregohet në figurën më poshtë:




2. Zgjedhim gjuhën “Shqip” djathtas lart dhe klikojmë tek butoni Regjistrohu. Hapet faqja e mëposhtme, në të cilën duhet të plotësojmë fushat përkatëse për t’u regjistruar në Portal. Plotësojmë fushat me të dhënat e kërkuara si më poshtë, klikojmë tek kutiza që kërkon miratimin tonë për përdorimin e të dhënave personale dhe më pas klikojmë mbi butonin Vazhdo për t’u regjistruar:




**Shënim:** *Në figurë jane disa shkrime me ngjyrë blu. Po të vendoset mouse mbi këto shënime do të shfaqen sqarimet përkatëse se ku gjenden, tek dokumentet e ndryshme të identifikimit, numri personal (kodi i përdoruesit), numri i kartës së identitetit, si dhe shfaqet deklarata për të dhënat personale bazuar në ligjin përkatës. Duhet pasur parasysh që*

*fjalëkalimi duhet të përmbajë të paktën gjashtë karaktere, me të paktën një numër dhe një shkronjë, si dhe nuk duhet të ketë hapësirë boshe në fjalëkalim. Fushat e e-mailit dhe të numrit celular duhet të plotësohen me të dhëna të sakta, pasi ato do të nevojiten më tej gjatë aplikimit. Në momentin e regjistrimit celulari duhet të jetë prezent, pasi aty do të dërgohet kodi i aktivizimit të profilit (kod 4-shifror). Nëse maturanti nuk ka celular, të japë numrin e celularit të mbikqyrësit në mënyrë që të vijojë procesi...*

3. Pasi klikojmë mbi butonin Vazhdo hapet faqja e mëposhtme, në të cilën kërkohet kodi i aktivizimit, i cili na është dërguar në numrin e celularit që plotësuam më sipër:




4. Plotësojmë fushën e kodit të kërkuar me kodin që na u dërgua me sms dhe klikojmë mbi butonin Perfundo. Shfaqet mesazhi që tregon se regjistrimi ynë në Portalin e-albania është kryer me sukses, siç tregohet në figurën më poshtë:




5. Pasi klikohet mbi linkun me ngjyrë blu "ketu", (*e njëjta gjë vlen edhe kur klikojmë mbi butonin* Hyr), shfaqet faqja ëeb si më poshtë me mënyrat e autentifikimit të kredencialeve tona në Portalin e-albania.




Zgjedhim mënyrën e dytë "CGG ofrues identiteti (UserID + Password)" dhe pasi klikojmë shfaqet faqja web, në të cilën na kërkohet të plotësojmë kredencialet tona për të bërë autentifikimin nga Portali. Zgjedhim gjuhën "Albanian" sipër dhe klikojmë mbi butonin OK. Tek fusha "kodi i përdoruesit" plotësojmë Numrin Personal dhe tek fusha "Fjalëkalimi" plotësojmë fjalëkalimin tonë dhe klikojmë mbi butonin Identifikohu (<u>*Numrin Personal dhe Fjalëkalimin që zgjodhëm në momentin që plotësuam fushat për regjistrimin*</u>), siç tregohet në figurën më poshtë:




**Shënim:** *Në rastin kur kemi harruar fjalëkalimin klikojmë mbi linkun "[Harruat fjalëkalimin tuaj]?". Do të hapet një fushë ku do të na kërkohet të plotësojmë Numrin Personal dhe duhet të klikojmë mbi butonin "Vazhdoni". Plotësojmë përgjigjen e duhur për "Pyetjen e Sigurisë" dhe klikojmë mbi linkun "Dërgo fjalëkalimin e ri". Fjalëkalimi i ri do të na dërgohet automatikisht tek adresa e-mail që kemi plotësuar gjatë regjistrimit në Portal (shiko pikën 2, faqe 1). Pas verifikimit nga Portali të të dhënave që plotësuam në pikën 5, nëse kemi hapur browser-in Firefox, hapet një dritare me një mesazh si më poshtë, tek e cila duhet të klikojmë patjetër butonin* Continue:




6. Pas verifikimit të të dhënave tona nga Portali e-albania shfaqet faqja web, në të cilën vëmë re që në vend të butonit Hyr është Emri_Mbiemri ynë dhe në vend të butonit Regjistrohu është butoni Dil, pra jemi në profilin tonë brenda Portalit e-albania, siç tregohet në figurën më poshtë:




7. Zgjedhim menunë "e-Shërbimet" dhe shfaqet faqja web, në të cilën listohen shërbimet që ofrohen nga Portali e-albania, si në figurën më poshtë:




8. Klikojmë mbi shërbimin **Matura Shteterore** dhe shfaqet faqja web, në të cilën përshkruhet shërbimi, mënyra sesi aplikohet për atë shërbim, dokumentacioni i kërkuar, procedura, si dhe videot ndihmëse shoqëruese, siç tregohet në figurën më poshtë:



9. Pasi klikojmë mbi butonin **Perdor Sherbimin** shfaqet ambjenti ynë i punës **Hapësira Ime** , siç tregohet në figurën më poshtë, në të cilën shfaqet shërbimi, për të cilin duhet të aplikojmë dhe konkretisht **Sherbimi elektronik i matures shteterore** :




Pasi klikojmë mbi shërbimin ose mbi linkun "Perdor" shfaqet faqja web si më poshtë:




10. Pasi kemi klikuar mbi linkun **Aplikim i Ri** shfaqen Formulari A1 ose Formulari A1Z në varësi të periudhës kur plotësohet secili prej tyre, siç tregohet në figurën më poshtë:






11. Klikojmë mbi linkun përkatës Apliko për të shfaqur formën përkatëse, qoftë për Formularin A1, qoftë për Formularin A1Z dhe për të plotësuar fushat e kërkuara. Formulari A1 shfaqet në formën siç tregohet në figurën më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

FORMULARI A1

PËR REGJISTRIMIN E MATURANTËVE NË MATURËN SHTETËRORE

Plotësohet vetëm nga maturantët që përfundojnë shkollën e mesme

*I. Të dhëna personale.*

1. Nr Personal në letërnjoftimin ID: I11024049B
2. Emri: Ilir  Atesia: Arben  Mbiemri: Bushi
3. Datëlindja (dd/mm/vv): 17/11/1995
4. Vendlindja e maturantit: Fier,Fier
5. Gjinia: (•) Mashkull ( ) Femer
6. Adresa email: ilir.bushi@yahoo.com  Celulari i kontaktit: 0692020201

*II. Të dhëna shkollore:*

7. Prefektura: TIRANË
8. Qytet / Fshati: TIRANË
9. Emri i shkollës ku studion: TIRANË - 379 - ISMAIL QEMALI
10. Indeksi i profilit:
11. Emërtimi i profilit:
12. Klasa III / IV: (A,B,C,D,E,F,G,H,I,J,K,L,M,N,O,P,Q,S,R,T): Viti: (•) III ( ) IV ( ) V  B
13. Do të aplikoni për studime jashtë vendit? ( ) Po (•) Jo

*III. Të dhëna lëndore:*

14. Lëndët me zgjedhje:

GJEOGRAFI BËRTHAMË
HISTORI BËRTHAMË

Shuma e krediteve: 10

Programi orientues i një lënde të thelluar përmban edhe programin përkatës të lëndës bërthamë. Përjashtim bëjnë lëndët e detyruara (Letërsi e gjuhë shqipe dhe matematikë)

Mbyll formën | Ruaj si draft | Dërgo aplikimin

**Shënim:** *Fushat e të dhënave personale janë të plotësuara automatikisht me të dhënat që kemi në Portalin e-albania (ato te dhëna që plotësuam dhe u verifikuan me regjistrin e gjendjes civile në procesin e regjistrimit në Portal). Plotësojmë edhe një herë numrin e celularit dhe verifikojmë adresën e-mail. Tek të dhënat shkollore plotësojmë në fillim prefekturën ku ndodhet shkolla jonë, në mënyrë që sistemi të ngarkojë listën e shkollave që ndodhen në atë prefekturë. Zgjedhim shkollën tonë dhe automatikisht plotësohet edhe fusha qytet/fshat. Plotësojme fushat e tjera të klasës dhe paralelit (psh. IIIA, IIIB, IVA etj) dhe nëse do të vazhdojmë studimet e larta jashtë vendit. Zgjedhim lëndët Z1 dhe Z2 që do të japim provim sipas kushteve të përcaktuara për kreditet, lëndët e njëjta, lëndët e shkollave artistike, lëndët e profileve profesionale etj... sipas udhëzimit nr.60, datë 26.12.2013 të MAS. Të vetmet fusha që nuk plotësojmë dot janë ato të indeksit dhe emërtimit të profilit.*

Formulari A1Z shfaqet në formën siç tregohet në figurën më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

FORMULARI A1Z

PËR REGJISTRIMIN E MATURANTËVE NË MATURËN SHTETËRORE
Plotësohet vetëm nga maturantët që kanë përfunduar shkollën e mesme

*I. Të dhëna personale.*

1. Nr Personal në letërnjoftimin ID: J46608094E
2. Emri: Ilir Atesia: Arben Mbiemri: Bushi
3. Datëlindja (dd/mm/vv): 07/11/1995
4. Vendlindja e maturantit: Tiranë, Tiranë
5. Gjinia: Mashkull Femer
6. Adresa email: ilir.bushi@yahoo.com Celulari i kontaktit: 0692020201

*II. Të dhëna shkollore:*

7. Prefektura: TIRANË
8. Qytet / Fshati: TIRANË
9. Emri i shkolles ku aplikoni: TIRANË - 379 - ISMAIL QEMALI
9.1 Shkolla qe keni perfunduar: E njejte Tjeter
10. Indeksi i profilit:
11. Emërtimi I profilit:
12 Do të aplikoni për studime jashtë vendit? Po Jo

*III. Të dhëna lëndore:*

13. ID e kandidatit:
14. Viti i perfundimit te shkolles se mesme:
15. Lendet e detyruara:
15.1 Lendet e detyruara qe do te mbarten:
Lenda D1: Nota e shkallezuar D1:
Lenda D2: Nota e shkallezuar D2:
15.2 Lendet e detyruara qe do te jepen provim:
Lenda D1:
Lenda D2:
16. Lendet me zgjedhje:
16.1 Lendet me zgjedhje qe do te mbarten:
Lenda Z1: Nota e shkallezuar Z1: Viti Z1:
Lenda Z2: Nota e shkallezuar Z2: Viti Z2:
16.2 Lendet me zgjedhje qe do te jepen provim:
Shuma e krediteve:

Programi orientues i një lënde të thelluar përmban edhe programin përkatës të lëndës bërthamë.
Përjashtim bëjnë lëndët e detyruara (Letërsi e gjuhë shqipe dhe matematikë)

Mbyll formen | Ruaj si draft | Dergo aplikimin

**Shënim:** *Fushat e të dhënave personale janë të plotësuara automatikisht me të dhënat që kemi në Portalin e-albania (ato te dhëna që plotësuam dhe u verifikuan me regjistrin e gjendjes civile në procesin e regjistrimit në Portal). Plotësojmë edhe një herë numrin e celularit dhe verifikojmë adresën e-mail. Tek të dhënat shkollore plotësojmë në fillim prefekturën ku ndodhet shkolla jonë, në mënyrë që sistemi të ngarkojë listën e shkollave që ndodhen në atë prefekturë. Zgjedhim shkollën tonë dhe automatikisht plotësohet edhe fusha qytet/fshat. Klikojmë mbi E njejte nëse shkolla ku kemi studiuar është po ajo ku po aplikojmë, në të kundërt klikojmë Tjeter dhe plotësojmë emrin e shkollës së mesme ku kemi studiuar dhe vendndodhjen e saj (p.sh. St. Stephen, Rome, Itali). Plotësojmë nëse do të vazhdojmë studimet e larta jashtë shtetit me Po ose Jo. Fushat e tjera janë inaktive për t'u plotësuar në formën e shfaqur në Portalin e-albania.*

12. Pasi të kemi plotësuar të gjitha të dhënat (*me përjashtim të fushave që janë inaktive*), klikojmë mbi:

   a. Butonin Mbyll formen, nëse duam ta mbyllim formën e Formularit A1 ose A1Z dhe të mos ruajmë asgjë që kemi plotësuar.... Shfaqet faqja web si në figurën më poshtë:




   Nëse duam të rikthehemi tek aplikimi ynë klikojmë mbi **Aplikim i Ri** dhe vazhdojmë si nga pika 10 e këtij manuali teknik e në vijim.

   b. Butonin Ruaj si draft, nëse duam ta ruajmë si draft aplikimin tonë dhe të kthehemi më vonë për të ndryshuar përsëri ndonjë të dhënë për të cilën nuk jemi të sigurtë. Pas klikimit te butonit shfaqet faqja web, siç tregohet në figurën me poshtë, për secilin nga rastet:







   Shënim: *Në figurën më sipër duket që Formulari A1 ose A1Z që ne plotësuam është ruajtur si Status "Draft" dhe nëse duam ta modifikojmë përsëri ose jo duhet të klikojmë mbi ikonën që të shfaqet përsëri forma e Formularit A1 ose A1Z. Nëse kemi dalë nga Portali e-albania dhe kemi hyrë përsëri, për të vazhduar aplikimin që kemi lënë draft duhet të klikojmë tek* Hapësira Ime *dhe më pas tek* Aplikimet e mia *, që të na shfaqet përsëri figura si më sipër.*

   c. Butonin Dergo aplikimin, nëse duam ta dërgojmë aplikimin tonë, sepse jemi të sigurtë në të dhënat tona që plotësuam. Pasi klikojmë mbi butonin Dergo aplikimin shfaqet faqja web, siç

tregohet në figurën më poshtë, në varësi të aplikimit:







Në figurën e mësipërme duket qartë që aplikimi ynë ka statusin "Dërguar" dhe se **duhet të paraqitemi në shkollën tonë për të përfunduar aplikimin**. Me të marrë këtë përgjigje kemi përfunduar pjesën kryesore të Formularit A1 ose A1Z dhe duhet të paraqitemi në shkollën tonë dhe së bashku me mbikqyrësin të përfundojmë, printojmë dhe nënshkruajmë formularin e printuar.

13. Dalja nga profili ynë në Portalin e-albania.

Për të dalë nga profili ynë klikojmë mbi butonin Dil (Dil) dhe kthehemi në faqen kryesore të Portalit e-albania.

**Shënim:** *Në përfundim të gjithë hapave të përshkruar më sipër çdo maturant do të paraqitet në shkollën ku studion dhe do të vijojë pjesën tjetër të aplikimit nga Portali i Maturës Shtetërore tek faqja http://matura.akp.gov.al/, nën udhëheqjen e mbikqyrësit të caktuar. Mbikqyrësi do të verifikojë për çdo maturant edhe një herë të dhënat e tij dhe sidomos plotësimin e kushteve për lëndët me zgjedhje Z1/Z2 sipas udhëzimit nr.60, datë 26.12.2013, ndryshuar me udhëzimin nr.3, datë 07.02.2014.*
*(Referoju tek http://akp.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=133&Itemid=285).*